



Emër Mbiemër : Pëllumb Xhufi
Datëlindje : 24.08.1951
Vendlindje : Durrës
Viti i zgjedhjes : 2020
Seksioni: Shkencat Shoqërore dhe Albanologjike
Komision i përhershëm: Komisioni i përhershëm i historisë dhe arkeologjisë
Gjuhët: Latinisht, Greqisht e vjetër, Frëngjisht, Gjermanisht, Anglisht, Italisht, Greqisht.

Kontakt

Adresa: Rr. Bogdanëve, P. 25, nr. 37, Tiranë
Telefon: 0692084730
E-Mail: pxhufi@gmail.com
Faqe zyrtare: www.akad.gov.al

CV e shkurtër

Studjues i historisë së mesjetës, pedagog, Drejtues Kërkimesh, anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Studimet universitare me rezultate të larta në Universitetin “La Sapienza” Romë (Itali), dega Letra Klasike (1972-1977). Studime postdoktorale në Këln (Gjermani) si bursist i Fondacionit “Humboldt” (1991-1992). Specializime të ndryshme për Paleografi Latine e Greqishte mesjetare në Itali, Austri, Greqi (1981, 1984, 1988, 1992). Filloi punë si përkthyes në Radio Televizionin Shqiptar (1977) për të kaluar më vonë në Institutin e Historisë të Akademisë së Shkencave, Sektori i Historisë Etnike (1981). Për gadi dy dekada ka dhënë lëndët “Histori e Bizantit” dhe “Histori e Italisë dhe e qytetërimit italian” në Fakultetin Histori-Filologji. Nga viti 1997 u ftua të punojë në Ministrinë e Punëve të Jashtme, si Drejtor i Ballkanit (1997-1998), Zvendës Ministër (1998-2002) e Ambasador në Romë (2002-2004). Aktiviteti i tij diplomatik ka patur si bosht çështjen e Kosovës dhe marrëdhëniet bilaterale me vendet fqinje. Ka qenë Deputet i Kuvendit për LSI (2005-2009), e më tej u rikthye në Institutin e Historisë si Shef i Departamentit të Mesjetës e të Rilindjes. Në periudhën e shkëputjes nga Instituti i Historisë (1997-2009) ka vazhduar aktivitetin shkencor, duke botuar tre monografi, artikuj të shumtë shkencorë e duke marrë pjesë në konferenca, kolokiume e seminare brenda e jashtë vendit. Ka qenë bashkpunëtor i revistës shkencore gjermane “Byzantinische Zeitschrift”, antar i redaksisë i “Studia Albanica” e “Studime Historike”, antar i Komitetit Shqiptar të AIESEE dhe i Komitetit Shqiptar të Studimeve Bizantine, Antar i bordit të Fondacionit “Fan Noli”. Ishte Kryetar i Komisionit për Veprimtaritë Shkencore me rastin e 550 Vjetorit të Gjergj Kastriot Skënderbeut (2018). Ka fituar çmimin “Kult” për monografinë “Shekulli i Voskopojës” (2011) dhe çmimin “Eqrem Çabej” të Akademisë së Shkencave për monografinë “Arbrit e Jonit: Vlora, Delvina e Janina shek. XV-XVII” (2017). Në vitin 2013 është shpallur “Qytetar Nderi i Vlorës” për kontributin e dhënë në studimin e historisë së qytetit.

Monografi

- *Dilemat e Arbërit. Studime mbi Shqipërinë mesjetare*, Tiranë: Pegi, 2006, f. 617 (përkthyer edhe në gjuhën maqedone).
- *Nga Paleologët te Muzakajt: Berati e Vlora shek. XI-XV*, Tiranë: Botimet 55, 2008, f. 463.

- *Ikje nga Bizanti*, Dituria, Tiranë, 2009, f. 293.
- *Shekulli i Voskopojës*, Tiranë: Toena, 2010, f. 463 (botuar edhe në maqedonisht).
- *Árbërit e Jonit. Vlora, Delvina e Janina në shek. XV-XVII*, Tiranë: “Onufri”, 2016, f. 1445.
- *Skënderbeu. Ideja dhe ndërtimi i shtetit*, Tiranë: Dituria, 2019, f. 237.

Vepra në bashkautorësi

- *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Tiranë: Akademia e Shkencave, 1985.
- *Historia e Popullit Shqiptar (Mesjeta)*, Tekst për klasën XI, Tiranë: Ministria e Arsimit, 1994.
- *Gli Statuti di Scutari*, Roma: Biella, 2002.
- *Byzance et ses périphéries. Hommage à Alain Ducellier*, Toulouse: Université Le Mirail, 2004.
- *Historia*, kl. IX, Tiranë: Mediaprint, 2009.
- *Historia e Popullit Shqiptar (Mesjeta, shek. V-XV)*, Tiranë: Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë, 2002.
- *The Living Skanderbeg. The Albania Hero between Myth and History*, Hamburg: Verlag Dr. Kovač, 2010.
- *Histori e Kosovës (Mesjeta)*, Prishtinë; Akademia e Shkencave dhe e Arteve, 2011.
- *L’Albania Veneta. La Serenissima e le sue popolazioni nel cuore dei Balcani*, Patrimonio Veneto nel Mediterraneo 6, Biblion Edizioni, Milano, 2012.
- *Çamëria. Vështrim historik dhe etno-kulturor*, Tiranë: Instituti i Studimeve “Çamëria”, 2015.
- *L’Adriatico tra sogno e realtà*, Alessandria: Edizioni dell’Orso, 2019.
- *Histori e Kosovës (Mesjeta)*, Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri” (në shtyp).

Përkthime veprash shkencore

- G. Ostrogorsky, *Histori e Perandorisë Bizantine*, përkth. nga italishtja, Tiranë (Dituria) 1994.
- C. Ginzburg, *Djathi dhe krimbat: bota e një mullisi në shek. XVI*, Përkthyer nga italishtja, Tiranë, 1998.
- G. Procacci, *Histori e Italianëve*, përkthyer nga italishtja, Tiranë, 2000.
- P. Petta, *Despotë të Epirit e princë të Maqedonisë*, përkthyer nga italishtja, Tiranë, 2001.
- P. Petta, *Stratitotët. Luftëtarë shqiptarë në Itali (shek. XV-XIX)*, përkthyer nga italishtja, Tiranë, 2005.
- L. Nadin, *Migrim e integrim. Rasti i shqiptarëve në Venedik (1479-1552)*, përkthyer nga italishtja, Tiranë, 2008.
- P. Bartl, *Ballkani Perëndimor mes Perandorisë Osmane dhe monarkisë spanjolle*, përkthyer nga gjermanishtja, Tiranë (Dituria), 2011.
- L. Nadin, *Shqipëria e rigjetur: zbulim gjurmësh shqiptare në kulturën e në artin e Venetos të shek. XVI*, përkthyer nga italishtja, Tiranë (Onufri), 2012.